

URDHËR
Nr. 405, datë 8.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE METODAVE SPECIFIKE TË
KONTROLLIT, TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË SALMONELOZËS NË SHPENDË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 16, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e kërkesave dhe metodave specifike të kontrollit të programit kombëtar të salmonelozës në shpendë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

RREGULLORE
**PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE METODAVE SPECIFIKE TË
KONTROLLIT, TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË SALMONELOZËS NË SHPENDË**

Neni 1

Kjo rregullore përcakton rregullat për përdorimin e substancave antimikrobike dhe administrimin e vaksinave në kuadër të programit kombëtar të kontrollit të salmonelozës në shpendë, bazuar në nenin 6 të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelozës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar me urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”.

Neni 2

Përdorimi i antimikrobikëve

1. Substancat antimikrobike nuk duhet të përdoren si metodë specifike për kontrollin e salmonelozave në shpendë.

2. Bazuar në pikën 1 dhe kushteve specifike në shkronjën “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 3, të këtij neni, përdorimi i substancave antimikrobike autorizohet në përputhje me nenin 5, të urdhrin nr. 370, datë 29.7.2014, “Për produktet mjekësore veterinarë”, vetëm në rastet e mëposhtme:

a) për shpendët që paraqesin shenja klinike të infeksionit salmonelar, ku ky infeksion ka shkaktuar lëngime të dukshme trupore. Tufa të infektuara me salmonelozë, konsiderohen edhe ata shpendë të trajtuar me substanca antimikrobike. Në tufat prindërore për riprodhim duhen marrë masat e duhura për uljen e rrezikut të përhapjes së salmonelozës në piramidën e riprodhimit apo tufave pasardhëse;

b) ruajtja e materialit të vlefshëm gjenetik në tufat prodhuese të shpendëve, në mënyrë që të sigurohen tufa pasardhëse të pastra nga salmoneloza, duke përfshirë “tufat elitare”, tufat pasardhëse të tufave prindërore në rrezik të prekjes nga salmoneloza dhe tufat që mbarështohen për qëllime kërkimore. Zogjtë e çelur nga vezë të inkubuara, që vijnë nga tufa prindërore të trajtuara me substanca antimikrobike, janë subjekt i marrjes së mostrave çdo 2 javë në fazën e rritjes, me një skemë që synon zbulimin e prevalencës deri në 1% të salmonelozës në tufë dhe me një kufi besueshmërie deri në 95%;

c) aprovimi i dhënë nga struktura përgjegjëse për veterinarinë që bazohet në parimin rast pas rasti për qëllime të tjera, nga ai i kontrollit të salmonelozës në tufat e dyshuara për infeksion salmonelar, në veçanti, gjatë hetimeve epidemiologjike pas shpërthimeve të toksinfeksioneve ushqimore ose zbulimit të salmonelozave në inkubatore apo njësi mbarështimi shpendësh. Struktura përgjegjëse për veterinarinë mund të lejojë trajtimin përpara autorizimit, në rastet e situatave emergjente, pas marrjes së mostrave nga veterinerë të autorizuar dhe raportimit të menjëhershëm të trajtimit të SPV-ja. Tufat konsiderohen të infektuara me salmonelozë nëse marrja e mostrave nuk është bërë në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi.

3. Përdorimi i substancave antimikrobike duhet të jetë subjekt i mbikëqyrjes dhe i raportimit nga Shërbimi Veterinar Rajonal të SPV-ja. Ky përdorim duhet të bazohet në rezultatet e kampioneve bakteriologjike dhe testeve të ndjeshmërisë së substancave antimikrobike. Kërkesat e përcaktuara në këtë nen nuk gjejnë përdorim për substancat, mikroorganizmat ose përgatitjet e autorizuara për t'u përdorur si shtesa ushqimore.

Neni 3 Administrimi i vaksinave

1. Vaksinat e gjalla të salmonelave nuk duhen administruar në kuadër të programeve kombëtare të kontrollit, në rastet kur prodhuesit e tyre nuk mundësojnë përdorimin e metodave të duhura për diferencimin bakteriologjik të shtameve të tjera më virulente të salmonelave nga ato të përfshira në vaksinë.

2. Vaksinat e gjalla të salmonelave nuk duhet të përdoren në kuadër të programeve kombëtare të kontrollit në tufat e shpendëve për vezë përgjatë prodhimit, përveç rasteve kur është testuar siguria e përdorimit të tyre dhe janë të autorizuara për këtë qëllim në përputhje me urdhrin nr. 370, datë 29.7.2014 “Mbi produktet mjekësore veterinarë”.

3. Programet e vaksinimit kundrejt *Salmonella Enteritidis* që ulin ndotjen dhe kontaminimin e vezëve, të aplikohen të paktën gjatë fazës së rritjes në të gjitha tufat për prodhimtari vezësh, për sa kohë që nuk është evidentuar një prevalencë nën 10% bazuar në rezultatet e monitorimeve të kryera, sipas nenit 4, të rregullores “Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë”, miratuar urdhrin nr. 273, datë 23.9.2020 “Për miratimin e rregullores ‘Mbi masat e kontrollit të salmonelës dhe agjentëve të tjerë zoonotikë’”, SPV-ja mund të bëjë përjashtim nga këto kërkesa në një stabiliment, nëse:

- përmbushen masat parandaluese në kapanonet e rritjes së zogjve dhe shpendëve në fazën e prodhimtarisë së vezëve;
- është demonstruar mungesa e shtameve *Salmonella Enteritidis* për 12 muajt e fundit përpara futjes së shpendëve për rritje dhe prodhim në kapanon.